



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË**

**PËRMBLEDHJE  
E MBLEDHJES SË TRETË TË KOMITETIT KOMBËTAR TË PAGESAVE (KKSP)  
e cila u mbajt**

të martën, datë 09 Maj 2017, nga ora 09.00 deri 12.00 në ambientet Hotel Tirana International.

Në mbledhjen e tretë të KKSP zj. Gjoni mbajti fjalën e saj në cilësinë e Kryetarit. Ajo falënderoi anëtarët dhe të ftuarit për pjesëmarrjen, si dhe theksoi mirënjohjen për angazhimin e të gjithë institucioneve të përfshira në projektet e ngritura nga KKSP. Më tej, zj. Gjoni theksoi rëndësinë që ka pjesëmarrja e institucioneve financiare të përfshira në fushën e shërbimeve të pagesave në këtë komitet. Në këtë kuadër, ajo theksoi se Banka e Shqipërisë do të punojë që përfaqësimi i tyre në KKSP të formalizohet nëpërmjet rishikimit të kuadrit rregullativ përkatës. Në vijim të fjalës së saj zj. Gjoni i parashtroi të pranishmëve objektivat e Komitetit për të ardhmen. Ajo theksoi se pavarësisht faktit që në fillimet e komitetit u miratua një strategji afatmesme, ajo mund të konsiderohet si një themel për specifikime dhe analizime të mëtejshme në kuadër të zhvillimit të tregut të pagesave. Në këtë drejtim zj. Gjoni theksoi tre boshte kryesore të cilat KKSP do të përqendrojë vëmendjen në vitin në vijim: i) krijimi i lehtësirave dhe hapësirave të nevojshme ligjore apo rregullative me qëllim nxitjen e përdorimit të instrumenteve inovative dhe të sigurta të pagesave; ii) rritja e mëtejshme të sigurisë së pagesave me internet në përputhje me praktikat më të mira; iii) rritja e mëtejshme e edukimit të publikut, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare të popullatës me fokus kryesor turizmin, duke ruajtur njëkohësisht fokusin tek mbrojtja e konsumatorit. Në këtë drejtim, zj. Gjoni nënvizoi dhe nevojën e përdorimit të platformave kombëtare të cilat ulin kostot e përdorimit të instrumenteve të pagesave. Në përfundim të fjalimit të saj kryetarja falënderoi Bankën Botërore me mbështetjen e SECO-s dhe Banca d'Italia të cilët me asistencën e tyre nëpërmjet realizimit të disa projekteve të rëndësishme, po mbështesin ndjeshëm zhvillimin e mëtejshëm të tregut të pagesave në Shqipëri me objektiv reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi nëpërmjet krijimit të një strategjie konkrete zhvillimi në këtë drejtim.

Pjesa e parë e mbledhjes mbi zhvillimet më të fundit në fushën e inovacionit, krimit kibernetik dhe mbështetjes së biznesit në lidhje me përdorimin e instrumenteve elektronik të pagesave u hap me fjalimin e përfaqësueses së Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike zj. Vilma Tomço. Në fjalën e saj zj. Tomço theksoi se Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike ka ndërmarrë një nga reformat më të rëndësishme e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve nëpërmjet instrumentave të fuqishëm që përdoren për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e tregut digjital. Sigurisht kjo është një tendencë botërore e cila konsiderohet edhe si revolucioni i katërt digjital, duke përfshirë pashmangshmërisht edhe Shqipërinë. Bëhet fjalë për inovacionin në Shqipëri të lidhur ngushtësisht me internetin dhe teknologjitë digjitale. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare është

angazhuar fuqimisht në mbështetjen dhe promovimin e iniciativave digjitale si një mjet i rëndësishëm për modernizimin e qeverisjes, rritjen e njohurive dhe shoqërisë sonë të hapur, zhvillimin ekonomik dhe pasurimin e qytetarëve. Për këtë qëllim po punohet për i) rritjen e Infrastrukturës digjitale në funksion të modernizimit të shtetit; ii) nxitjen e sektorit privat për zgjerimin e ofrimit të internetit në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe iii) zhvillimi i e-qeverisjes dhe shoqërisë së informacionit, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën duke përfshirë edhe transaksione monetare. Në përfundim të fjalimit të saj zj. Tomço përshkroi mënyrën e hartimit të reformës së sipërcituar si dhe disa tregues mbi suksesin e kësaj reforme.

Në vijim të këtij seksioni, fjalën e mori përfaqësuesja e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes zj. Mirela Muça. Ajo u fokusua në punën e bërë nga institucioni që përfaqëson në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit. Në këtë drejtim, ajo theksoi se Ministria në përmbushje të mandatit të saj është kujdesur për hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, ndërkohë që rishtazi ka ndërmarrë dhe hapa konkretë në kuadër të trajtimit të ankesave të tyre, duke krijuar strukturat përkatëse. Në këtë kuadër, Ministria ka krijuar Komisionin e mbrojtjes së Konsumatorit dhe një sektor pranë Ministrisë e cila mbështet punën e Komisionit. Pavarësisht se këto struktura gjenden në hapat e tyre të parë, reforma territoriale dhe bashkëpunimi me pushtetin vendor kanë dhënë kontributin e tyre në fushatën sensibilizuese që ka ndërmarrë Ministria. Së fundmi, zj. Muça vuri theksin në rëndësinë e zhvillimit të tregut të pagesave elektronike, shërbim ky që ndikon në zhvillimin e turizmit në vend. Duke marrë në konsideratë faktin se turizmi po bëhet një sektor gjithnjë e më i rëndësishëm për ekonominë shqiptare, si dhe faktin që klientët e këtij sektori në shumicën e rasteve janë qytetarë të huaj të cilët janë tepër familjarë me përdorimin e pagesave elektronike, krijimi i një kulture për promovimin e këtyre instrumenteve edhe nga ana e bizneseve është tepër i rëndësishëm.

Në përfundim të pjesës së parë të mbledhjes, fjalën e mori zj. Luljeta Ismailukaj përfaqësuese nga Ministria e Punëve të Brendshme. Përfaqësuesja prezantoi përvojën e deritanishme të institucionit në përjasjen e krimit kibernetik në shërbimet bankare. Në këtë kuadër, u diskutua mbi tre format kryesore të hasura deri më tani në tregun shqiptar në lidhje me mashtrimin e shërbimeve bankare. Në këtë kuadër përfaqësuesja shprehu nevojën për bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë mes institucioneve qeveritare si dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave në fushën e krimit kibernetik si dhe të sistemit bankar me bankat e huaja, me qëllim parandalimin e tyre. Për më shumë në lidhje këtë çështje, fjalën e mori zj. Najada Xhaxha, kryetare e Komitetit të Pagesave pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe anëtare e KKSP. Në ndërhyrjen e saj zj. Xhaxha nënvizoi se mashtrimi në shërbimet bankare paraqitet të jetë i sofistikuar dhe në shumicën e rasteve i pa shmangshëm vetëm me kontributin e masave nga ana e Bankave. Për këtë qëllim sistemi bankar po punon për ndërgjegjësimin e klientëve, ku janë dhe fillesat e problematikës dhe shanset më të mëdha për minimizim të rrezikut. Këto masa duket se kanë dhënë frytet e para në këtë drejtim. Gjithashtu, zj. Xhaxha nënvizoi se bankat kanë ndërmarrë masa në kuadër të krijimit të mekanizmave që minimizojnë efektet e mashtrimit dhe rrisin sigurinë e instrumenteve të pagesave të përdorura. Megjithatë ajo ritheksoi se mjete kryesor në këtë drejtim është rritja e edukimit financiar të klientëve.

Pjesa e dytë e mbledhjes së KKSP iu dedikua rezultateve dhe rekomandimeve mbi projektet e ndërmarrë nga Banka Botërore si dhe perspektiva për të ardhmen. Në fillimin e këtij seksioni zj. Gjoni ftoi të ftuarin nga Banka Botërore z. Mario Guadamillas, Menaxher për Evropën dhe Rajonin, pranë Bankës Botërore për një fjalim përshëndetës. Z. Guadamillas pasi falënderoi për ftesën në mbledhjen e KKSP si dhe bashkëpunimin e frytshëm deri më tani midis dy institucioneve në fushën e pagesave, u përqendrua në prezantimin e një panorame të përgjithshme të masave dhe projekteve që ka ndërmarrë Banka Botërore në nivel ndërkombëtar. Z. Guadamillas, si përfaqësues i strukturave në lidhje me pagesat pranë Bankës Botërore, në të shkuarën ka qenë pjesë e këtyre projekteve dhe ndihet tepër familjar me tematika dhe komitetet të ngjashme si KKSP. Në këtë drejtim, z. Guadamillas theksoi se KKSP po ndjek parimet dhe objektivat e duhura.

Në vijim të pjesës së dytë, përfaqësuesit e Bankës Botërore prezantuan një përmbledhje të rezultateve dhe rekomandimeve të projekteve të ndërmarrë prej tyre në fushën e përfshirjes financiare për nga këndvështrimi i pagesave si dhe në lidhje me projektin e remitançave ndërkombëtare. Në këtë kuadër, përfaqësuesit u fokusuan në shtyllat kryesore në të cilat kërkohet ndërhyrje të tilla si zgjerimi i popullsisë të cilët zotërojnë një llogari bankare dhe promovimi i përdorimit të tyre, tregues këto të përfshirjes financiare që paraqiten në nivele të ulëta në Shqipëri krahasuar me vendet e rajonit por dhe më gjerë. Ndërhyrjet kryesore të propozuara lidheshin kryesisht me tre shtylla kryesore si zhvillimi i infrastrukturave që mbështesin shërbimet, zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ të fushës si dhe, bashkërendimi i veprimeve të sektorit publik dhe atij privat në kuadër të promovimit të përfshirjes financiare.

Në mbyllje të këtij seksioni, fjalën e mori zj. Gjoni, e cila theksoi rëndësinë që kanë këto projekte për zhvillimin e sistemeve të pagesave me pakicë në Shqipëri. Realizimi i këtyre projekteve do të kontribuojë ndjeshëm për hartimin e një strategjie zhvillimi afatmesme me objektiva dhe hapa konkrete për palët e përfshira.

Mbledhja e tretë e KKSP vijoi me seksionin e tretë ku prezantimet e mbajtura nga Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Drejtoresha e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financave në Bankën e Shqipërisë paraqitën arritjet e deritanishme dhe sfidat në të ardhmen në kuadër të përmbushjes së strategjisë afatmesme të KKSP.

Më konkretisht, ky seksion u hap me fjalimin e z. Periklis Drougkas në lidhje me risitë e prezantuara nga sektori bankar gjatë vitit në fushën e *banking*-ut elektronik. Në fjalimin e tij z. Drougkas analizoi zhvillimin e platformave për *banking*-un elektronik nga disa banka si dhe risitë e bankave tregtare në procesin e verifikimit të identitetit të klientit. Për më shumë, z. Drougkas prezantoi dhe shërbimet inovative të ofruara nga bankat përsa i përket kartave bankare. Gjatë fjalimit të tij, Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave bëri një përmbledhje të projekteve të KKSP-së të finalizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave si dhe ato në vijim si debitimi direkt. Në përfundim të fjalës së tij z. Drougkas prezantoi gjithashtu edhe të gjitha nismat e ndërmarrë nga Shoqata gjatë kësaj periudhe në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit dhe rrahjes së mendimeve të tilla si” konferenca mbi “*Banking*-un Digjital”, Forumi i Sigurisë së Informacionit si dhe Forumin e parë për *banking*-un me pakicë.

Në përfundim të fjalimit të z. Drougkas, zj. Gjoni ndërhyri për të theksuar rëndësinë e vijimit të projektit të Debitimit Direkt ndërbankar. Për këtë qëllim ftoi të gjithë aktorët për të bashkëpunuar më ngushtë në lidhje me realizimin e këtij projekti.

Në vijim të këtij seksioni fjalën e mori zj. Anjeza Beja e cila mbajti një prezantim mbi transpozimin e Direktivës së “Shërbimeve të pagesave në tregun e brendshëm” si dhe mbi dokumentin me rekomandime të Autoritetit Bankar Evropian (EBA) në lidhje me sigurinë e pagesave me internet, dy projekte këto tejet të rëndësishme të iniciuara nga Banka e Shqipërisë në fushën e pagesave. Në prezantimin e saj zj. Beja, jo vetëm prezantoi përmbajtjen e direktivës dhe rekomandimeve, por bëri dhe një përshkrim të shkurtër mbi situatën aktuale të tregut shqiptar, përfitimet që sjell implementimi i këtyre projekteve dhe masat që pritet të merren apo që tashmë janë ndërmarrë në përmbushje të tyre.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave Z. Lavdrim Sahitaj në ndërhyrjen e tij, theksoi rëndësinë e pasurimit të mëtejshëm të bazës së statistikave si dhe nevojës për rritjen e mëtejshme të sigurisë në përdorimin e instrumenteve inovative të pagesave.

Më tej, kryetarja zj. Gjoni ftoi anëtarët e Komitetit të studiojnë projekt rekomandimet e hartuara nga sekretariati, me qëllim miratimin e tyre.

Më pas zj. Gjoni, duke theksuar edhe një herë rëndësinë e pjesëmarrjes së institucioneve financiare jo banka dhe operatorëve privatë, i ftoi ato për diskutim.

Nga ana e institucioneve financiare jobanka, përfshirë atyre të emetimit të parasë elektronike si dhe operatorëve të elementëve të rëndësishëm të sistemeve të pagesave dhe institucioneve qeveritare pati një pjesëmarrje aktive me pyetje, komente dhe sugjerime. Ndërhyrjet e bëra nga subjektet M-Pay, Easy Pay, M-Pesa, Ak-Invest apo Paylink konsistonin kryesisht në prezantimin e risive të tyre gjatë këtij viti, evidentimin e disa problematikave që subjektet hasin në ushtrimin e këtyre veprimtarive në tregun vendas si për shembull hapja e llogarive pranë bankave, sugjerime për digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve publike, nëpërmjet përdorimit të faturës elektronike në shërbimet qeveritare, si dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me implementimin e direktivës së shërbimeve të pagesave. Anëtarët e komitetit shprehën angazhimin për të diskutuar në terma më konkret në lidhje me problematikat e adresuara prej tyre.

Në përfundim të diskutimeve dhe mbledhjes së tretë të KKSP, Kryetari e deklaroi atë të mbyllur.

## **Rekomandimet e KKSP për vitin në vijim si dhe propozimi për datën e mbledhjes së rradhës**

*Në përmbushje të Strategjisë Afatmesme 2015-2020 të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, në kuadër të përpjekjeve për reduktimin e parasë fizike në ekonomi dhe objektivave të lidhura me rritjen e përfshirjes financiare të popullatës, konkluzionet e dala gjatë diskutimeve në mbledhje Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave i reflekton në rekomandimet më poshtë:*

1. Banka e Shqipërisë, me mbështetjen e Bankës Botërore, të angazhohet të punojë për hartimin e një strategjie afatmesme për pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri, e cila të marrë në konsideratë rekomandimet e lëna në raportet më të fundit të Bankës Botërore. Gjithashtu, nevojitet angazhim i të gjitha institucioneve anëtare të Komitetit për sugjerime dhe komente mbi projekt strategjinë që do të përcillet për mendim, sipas fushave që mbulojnë.
2. Vijimin e punës për hartimin e projekt ligjit „Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm“. Për këtë qëllim, rekomandohet që:
  - a. Banka e Shqipërisë të përfundojë projektin dhe të konsultojë këtë dokument me të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave në Shqipëri.
  - b. Banka e Shqipërisë të përcjellë projektin pranë KKSP për sugjerime të mëtejshme. Autoritetet përkatëse anëtare të komitetit, ftohen të përcjellin komentet dhe sugjerimet e tyre mbi projektin e dërguar nga Banka e Shqipërisë.
  - c. Banka e Shqipërisë, ndjek hapat e mëtejshëm që shoqërojnë miratimin e një projekt ligji në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Hartimin e një dokumenti me rekomandime të nxjerra nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave në lidhje me sigurinë e pagesave me internet, në përputhje me rekomandimet e Autoritetit Bankar Europian (EBA). Për këtë qëllim:
  - a. Banka e Shqipërisë të hartojë projekt dokumentin me rekomandime, duke marrë në konsideratë edhe komentet e bankave tregtare (nëpërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave).
  - b. Banka e Shqipërisë të përcjellë për miratim në Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave dokumentin me rekomandime, i cili të publikohet më pas në faqen e internetit të KKSP në adresë së sektorit bankar.
  - c. Sektori bankar rekomandohet të marrë masat e nevojshme për adresimin e rekomandimeve me qëllim rritjen e sigurisë në kryerjen e pagesave me internet dhe rritjen e besimit të publikut në përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.
  - d. Ftohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shoqata Shqiptare e Bankave që të bashkëpunojnë për analizimin dhe adresimin e çështjeve problematike në fushën e krimit kibernetik si dhe nxitjen e bashkëpunimit në këtë kuadër.
4. Përfshirjen e të gjitha strukturave apo autoriteteve të nevojshme për vënien në zbatim të planit të veprimit të sugjeruar nga Banka Botërore në raportin e vlerësimit të tregut të remitancave në Shqipëri, me qëllim përmbushjen e objektivave të synuar brenda afateve të përcaktuara.

5. Brenda vitit 2017, Shoqata Shqiptare e Bankave të konsiderojë rekomandimin e lënë nga Banka Botërore në lidhje me rëndësinë që ka për tregun shqiptar vlerësimi i mundësive nga ana e bankave për aplikimin e një platforme *Switch*-i për procesim kartash. Një platformë e tillë rrit ndërveprimin (*interoperability*) mes subjekteve të ndryshme si dhe ndikon në rritjen e konkurrencës me kompanitë ndërkombëtare të kartave që operojnë sot në Shqipëri. Gjithashtu, Shoqata Shqiptare e Bankave të diskutojë me subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtari pagesash dhe transferimi parash dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi të adresojë problematikën e hasur prej tyre në hapjen e llogarive.
6. Bankat tregtare të çojnë deri në fund projektin e debitimit direkt ndërbankar, në përputhje me planin e veprimit të dakorduar. Për këtë qëllim, Shoqata e Bankave duhet të angazhohet në ndjekjen e të gjitha hapave të nevojshme dhe të koordinojë komunikimin me shoqëritë utilitare dhe bankat e përzgjedhura prej tyre. Implementimi i këtij projekti, është njohur si një mjet mjaft pozitiv nga ana e Bankës Botërore në raportet e saj, i cili ndihmon në përfshirjen financiare të popullatës. Nga ana tjetër, ky projekt ndihmon në rritjen e konkurrencës pasi bankat më të vogla me një shtrirje më të kufizuar vijnë të mbajnë klientët e tyre dhe të zgjerojnë aktivitetin, por nga ana tjetër rrit edhe bashkëpunimin mes bankave për sa lidhet me përdorimin e infrastrukturës.
7. Ftohet Ministria e Financave dhe Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike të bashkëpunojnë me institucionet bankare dhe financiare jobanka në kuadër të nxitjes së digjitalizimit të shërbimeve publike, nëpërmjet përdorimit të faturës elektronike në shërbimet qeveritare si dhe përdorimit të instrumenteve elektronike në shërbimet publike të tilla si transporti publik.
8. Ftohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të angazhohet në fushata promovuese apo projekte të tjera me qëllim nxitjen dhe promovimin e përdorimit dhe pranimit të instrumenteve të pagesave elektronike nga bizneset e hotelerisë në fushën e turizmit dhe të vijnë përpykjet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.
9. Rishikimin e rregullores së funksionimit të KKSP me qëllim adresimin e:
  - a. Rekomandimeve të lëna në raportin e BB mbi përfshirjen financiare, të cilat konsistojnë në përfshirjen në komitet të përfaqësuesve të subjekteve financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e pagesave. Për këtë qëllim, ftohen këto subjekte të zgjedhin përfaqësuesin e tyre si anëtar në këtë komitet.
  - b. Rishikimit të periodicitetit të mbledhjes së Komitetit nga dy herë në vit, në të paktën një herë në vit, me qëllim pasjen e një kohe më të gjatë në dispozicion për përfundimin e projekteve dhe raportimin e konkluzioneve për Komitetin.
  - c. Të tjera që mund të sugjerohen nga anëtarët, nëse është e nevojshme.

10. Mbledhja e radhës: Maj 2018

**Pjesëmarrësit në mbledhjen e KKSP**

<b>Anëtarët e Komitetit të pranishëm në mbledhje</b>	<b>Sekretariati</b>	<b>Shoqërues të anëtareve</b>	<b>Të ftuar</b>
Zj. Elisabeta Gjoni Banka e Shqipërisë (BSH)	Zj. Valentina Semi (BSH)		Z. Indrit Xhemali (BSH)
Z. Periklis Drugkas Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB)	Zj. Brunilda Kostare (SHSHB)		Zj. Eneida Thomaj (Paylink) Zj. Irida Huta ( Paylink)
Z. Ervin Koçi Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)		Zj. Flora Musta (AMF)	Zj. Elona Lekloti (MPesa) Z. Dorien Meçe (MPesa)
Zj. Vilma Tomço Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike (MIAP)			Zj. Bora Feri (MPay)
Z. Lavdrim Sahitaj Ministria e Financave (MF)		Zj. Mimoza Peco (MF) Zj. Aurela Velo (MF)	Zj. Linda Shomo (EasyPay) Zj. Matilda Hasanaj (EasyPay)
Zj. Mirela Muça Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS)			Z. Altin Uka (OSHEE) Z. Johan Sterjo (OSHEE) Z. Andi Erebara (OSHEE)
Zj. Luljeta Ismailukaj Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)			Zj. Stela Nenada (UKD) Z. Denis Gjoni (UKD)
Zj. Najada Xhaxha Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB)			Z. Ilir Adili (Ak-Invest) Z. Elton Çollaku (UFT)
Zj. Anjeza Beja Banka e Shqipërisë (BSH)		Z. Valer Miho (BSH) Zj. Marsida Ganaj (BSH) Zj. Edlira Hoxha (BSH)	Zj. Ardita Soko (Posta Shqiptare) Zj. Ridvana Kottoni (Posta Shqiptare)
Z. Deniz Deralla Banka e Shqipërisë (BSH)			Zj. Erisa Bojaxhiu (Albtelecom) Zj. Elona Gorana (Albtelecom)
<b>Të ftuar specialë</b>			
Z. Mario Guadamillas Menaxher pranë Bankës Botërore për Evropën dhe Rajonin			
Zj. Maria Teresa Chimenti Banka Botërore			
Z. Jose Antonio Garcia Banka Botërore			
Zj. Johanna Jaeger Banka Botërore			
Z. Keler Gjika Banka Botërore			